

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Eco Buildings Albania” (EBACO) sh.p.k**

**Titulli I
Emërtimi – objekti
Selia – kohëzgjatja**

Neni 1

Sot në Tiranë më datë 23.05.2022, unë Ortaku dhe themelues i vetëm:

- 1.1 Shoqëria private me përgjegjësi të kufizuar “ECO BUILDING GROUP” LTD, me Nr. Regjistrimi 13774419, me seli në Angli, 3 Galley House, Moon Lane, Barnet , Angli, EN5 5YL, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga Av. Rigert Koni, me Nr. Liç 6450, NUIS L72223041S, Antarë I Dhomës së Avokatisë Tiranë, me daresë, Rr. “Xhanfize Keko” , Nd. 8, Tiranë.
- 1.2 Vendosa të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “Eco Buildings Albania” (EBACO) shpk.

Neni 2

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “Eco Buildings Albania” (EBACO) sh.p.k është:

- 2.1 Aktivitet ne fushen e ndertimit me fondet e veta ose publike te objekteve te ndryshme industriale dhe civile te cdo lloji, per vete apo per te trete, private dhe/ose publike, si dhe restaurimi apo riparimi i tyre, marrja e te drejtave dhe cdo lloj avantazhi ne cdo lloj forme ligjore qe eshte e domosdoshme per realizimin e qellimeve te shoqerise, si dhe shfrytezimi i te gjitha sipermarrjeve qe kane te bejne me veprimtarine e mesiperme, ne kufijte e lejuar nga lgji;
- 2.2 Kryerja e sherbimeve te projektimit, zbatimit, montimit, supervizimit, kolaudimit per punime ndertimi dhe infrastrukturre;
- 2.3 Projekte te te gjitha llojeve ne ndertim, infrastrukture, hidroenergjistik, vepra arti dhe arkitekture.
- 2.4 Ndertim rrugesh te te gjitha kategorive, autostrada, mbikalime, vepra hidrike, vepra arti, te urave, ujesjellesave, kanalizimeve, germimeve te dheut, hapje rrugesh, hapje kanalesh, etj., me makineri dhe pajisje te ndryshme.
- 2.5 Zhvillim zonash me qellime rezidenciale dhe tregtare, shitje-blerje e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme.
- 2.6 Ushtrimi i cdo lloj operacioni dhe transaksioni ne lidhje me importimin, eksportimin, prodhimin, tregtimin, shitjen, shperndarjen e pajisjeve dhe materialeve te ndryshme elektrike, elektromekanike, materiale ndertimi, ekologjike apo materiale te tjera ne fushen e ndertimit, si me shumice dhe pakice, ne formen e lendet se pare, gjysme te gatshme, makineri dhe pajisje, teknologji, etj.
- 2.7 Import-Eksport.
- 2.8 Prodhami i lëndës së parë për ndërtim dhe produkteve gjysmë të gatshme për ndërtimin, si dhe elementeve të parafabrikura për ndërtesa civile dhe industriale;
- 2.9 Prodhami i inerteve dhe lëndëve të tjera që nxirren nga guroret, si dhe rikuperimi dhe/ose ripërdorimi i tyre për ndërtimin në përgjithësi;

- 2.10 Blerja dhe shitja, edhe e pjesshme, menaxhimi, administrimi dhe prokurimi i pasurive të palujtshme edhe nëse jo të destinuara për arritjen e objektit të saj kryesor;
- 2.11 Transporti për llogari të vet dhe të tretëve, që do të kryhet me mjetet e tyre dhe / ose palëve të treta, brënda dhe jashtë vendit;
- 2.12 Gjetja, organizimi, transferimi dhe ekzekutimi i transportit të të gjitha llojeve, sistemeve, produkteve ose të mallrave;
- 2.13 Aktiviteti specifik i transportit kombëtar dhe ndërkontinentar, me mjetet e veta dhe / ose palëve të treta;
- 2.14 Menaxhimi i depozitave për mallrat dhe / ose produktet që kanë të bëjnë me sektorin e ndërtimit.
- 2.15 Për ndjekjen e qëllimit te saj, kompania do mund të përfitojnë nga çdo lehtësi fiskale, financiare, për sigurimet shoqërore dhe kredi, të parashikuata nga ligjet në fuqi si vendase ashtu dhe të huaja.
- 2.16 Shoqëria mund të kryejë edhe çdo lloj aktiviteti tjeter ndihmës dhe të nevojshëm, që ka lidhje të mjaftueshme me këtë objekt aktiviteti dhe që nuk ndalohet nga ligjet Shqiptarë në fuqi.
- 2.17 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë sic parashikohet në këtë statut.
- 2.18 Shoqëria mund të marrë të drejtën e përfaqësimit në Shqipëri të individëve, shoqërive apo organizatave vendase apo të huaja .

Neni 3

- 3.1 Selia e shoqërisë “**Eco Buildings Albania**” (EBACO) sh.p.k do të jetë në Rrugë “Frosina Plaku”, Pl.21, Hyrja 13, Kati 1, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2 Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Neni 4

Residencia ligjore e ortakut për çdo raport me shoqërinë është selia e shoqërisë

Neni 5

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.


Neni 6

Shoqëria mund të krijojë degë apo përfaqësi të saj brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Titulli II **Kapitali Të shoqërisë dhe Kuotat**

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontribute në të holla me vlerë prej 100 000 (njëqindmijë) lekë, e cila do të depozitohet në llogari të shoqërisë, në një Bankë të nivelit të dytë, pas regjistrimit në QKB .



2

Neni 8
Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

Ortaku i Shoqërisë dhe kuota e zotëruar prej tij në Shoqëri janë si më poshtë:
Shoqëria private me përgjegjësi të kufizuar “ECO BUILDING GROUP” LTD zoteron 1 kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 9
Çertifikata e kuotave

- 9.1 Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotat e zotëruara bashkarisht nga disa persona dhe dorëzimi i çertifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të kuotave , në përpunje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit .
- 9.2 Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në çertifikatën e kuotës.
- 9.3 Çertifikata nuk do të gjëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 10

- 10.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme midis ortakëve.
- 10.2 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj..
- 10.3 Në rast se një ortak do të shesë, transferojë, ose të disponojë në mënyra të ndryshme pjesë apo të gjithë kuotën e tijë, ortaku tjetër do të ketë të drejtën e parablerjes, kundrejt blerësve të tjerë. Nëse ortaku me të drejtë parablerje do të ketë bërë një ofertë dhe kjo ofertë është refuzuar nga ortaku që shet, atëherë ortaku që shet nuk do të ketë të drejtë të shesë kuotën tek një blerës tjetër me cmim më të ulët se cmimi i ofruar nga ortaku i preferuar.
- 10.4 Njoftimi për shitje do të bëhet me shkrim. Nëse brenda një muaji askush nga ortakët e shoqërisë nuk ofrohet për t’I blerë, atëherë shitësi është I lirë t’I shesë kuotat jashtë bashkësisë së shoqërisë.
- 10.5 Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi I kuotës, nga çasti I kalimit të kuotave, deri në çastin e rregjistrimit të kalimit të kuotave.
- 10.6 Shoqëria regjistron kalimin e kuotës sipas nenit 43 të ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi I kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.
- 10.7 Transferimi I kuotave ortakëve të shoqërisë apo të tretëve që nuk bëjnë pjesë në shoqëri do të bëhet me shkrim dhe do të vërtetohet nga Noteri Publik.

Neni 11
Blerja e kuotave të veta



A handwritten signature in black ink, appearing to read "Florjancic", is placed here. A small number "3" is written near the bottom right corner of the signature.

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta, dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre. Këtë mund ta bëjë vetëm nëse shoqëria ka aftësi paguese, sipas termit dhe përkufizimeve të nenit 77 të ligjit. Nëse nuk respektohen parashikimet e ligjit për këtë qëllim, atëherë mund të ngrihen padi qoftë kundër administratorit ashtu edhe kundër shoqërisë.

Titulli III Asambleja e Përgjithshme

Neni 12 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë thirret nga Administratori I shoqërisë në çdo kohë kur e kërkojnë jo më pak se 5 % e kuotave të kapitalit të shoqërisë (personat që zoterojnë këtë përqindje kapitali). Në kërkësen e tyre ortakët sa më sipër duhet të rendisin shkaqet se përsë kërkohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme. Me të marrë këtë kërkësë Administratori I shoqërisë është I detyruar të caktojë datën e mbledhjes dhe të bëjë njoftimet përkatëse sipas ligjit.
- 12.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*e-mail*) drejtar çdo ortaku përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpëra datës së caktuar për mbledhjen, përveç rasteve kur njoftimi I mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, I cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga shumica e ortakëve të cilët zoterojnë jo më pak se 80 % të kapitalit *të shoqërisë*. Secilit ortak.
- 12.3 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme të njoftimit apo mosmarrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi I ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 13 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme


- 13.1 Asambleja e Përgjithshme merr vendime të zakonëshme të vlefshëm, me shumicë votash vetëm nëse në mbledhjen e saj marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë jo më pak se 50 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë.
- 13.2 Për vendimet e asamblesë lidhur me: ndryshimin e statutit, zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, mbledhja e asamblesë është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë me të drejtë vote (vetë ose të përfaqësuar) që zoterojnë jo më pak se 70 % të kuotave të kapitalit. Vendimet e asamblesë për çështjet sa sipër duhet të merren nga jo më pak se 3/4 e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 13.3 Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio osc audio –video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit.
- 13.4 Administratori cakton Kryetarin e mbledhjes si dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

- 13.5 Nëse Administratori nuk dëshiron të caktohet si kryetar I mbledhjes ose nëse administratori nuk është I pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes , ortakët e pranishëm dhe me të drejtë votë zgjedhin njërin prej tyre si kryetar të mbledhjes.
- 13.6 Administratori , (edhe kur nuk është ortak) ka të drejtën e pjesëmarries si dhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
- 13.7 Kryetari , me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj , mund (dhe është I detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme) të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato Çëshje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi I mbledhjes së shtyrë dhe përshtrimi I përgjithshëm I rendit të ditës. Në rast të kundërt , dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
- 13.8 Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim I fshehtë. Votimi I fshehtë mund të kërkohet nga :
- *Administratori*,
 - Një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë përqind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues I autorizuar I ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortaku .
- 13.9 Me përjashtim të kundërshtimit të një ortaku, deklarimi I kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
- 13.10 Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë do të zhvillohet një votim I fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 14 Votat e Ortakëve

- 14.1 Në përputhje me të drejta ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë I jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit e tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) I cili është I pranishëm përmes përfaqësuesit të tij ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- 14.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme , personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve , në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.
- 14.3 Çdo kundërshtin në kohë për cilësinë e një votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi I të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të janë të vlefshme.

Neni 15 Votimi me Prokurë



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Tunc' or a similar name, with the number '5' written above it to the right.

- 15.1 Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku në formën e zakonshme apo në formën që mund të caktohet nga administratori). Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga administratori depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin përmbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.
- 15.2 Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (email) sipas përcaktimeve të pikës 3 e të nenit 4 të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 16 Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme


Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për shoqerinë për marrjen e vendimeve të mëposhtëme:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Ndryshimet e statutit të shoqërisë;
- Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- Përcaktimin e shpërbllimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërisë;
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Përfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera kundër Administratorëve;
- Riorganizimin, ndarjen, prishjen dhe likuidimin e shoqërisë.

Neni 17 Hetimet e posaçme

- 17.1 Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të vendsë fillimin e një hetimi të posaçëm gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe për këtë cakton një ekspert të fushës përkatëse.
- 17.2 Ortakët që përfaqësojnë jo më pak se 5 % të kuotave të kapitalit dhe çdo kreditor I shoqërisë mund t’I kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme të emërojë për qëllime hetimi një ekspert të pavarur të fushës. Në këtë rast nëse Asambleja brenda 60 ditëve nga depozitimi I kérkesës nuk mer vendim, kérkesa e subjekteve sa sipër vlerësohet e refuzuar. Nëse subjektet e mësipër dyshojnë në performancën e ekspertit mund ti kërkojnë Gjykatës zëvendësimin e tij.

Neni 18 Largimi dhe Përashtimi I Ortakëve



6

- 18.1 Secili ortak mund të largohet nga shoqëria nëse për çfarëdolloj shkaku që ai çmon se vazhdimi I ortakërisë është I pamundur. Për këtë ortaku duhet të njoftojë me shkrim shoqërinë, në të cilin duhet të parashtrojë dhe shkaqet e largimit. Nëse vërtetohet një rast I tillë Administratori I Shoqërisë duhet të thërrasë mbeldhjen e Asamblesë dhe do të procedohet sipas gjithë parashikimeve të nenit 101 të Ligjit.
- 18.2 Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë mund t’I kërkojë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përjashtimin e ortakut të shoqërisë, për gjithë shkaqet e parashikuara në nenin 102 të Ligjit. Edhe për procedurën e mëpasme do të respektohen gjithë parashikimet e këtij nenit.

Titulli IV Administrimi

Neni 19

- Shoqëria “Eco Buildings Albania” (EBACO) sh.p.k do të administrohet nga administratori:
- 19.1 Z. Genard Kadiu, i biri i Ramazan dhe i Miranda, i datëlindjes 21.04.1984, lindur dhe banues në Tiranë, me daresë Rr. “Ismail Qemali” Pl. Grean Park, Kulla 1, Ap.33 identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me Nr. I40421022N, madhor, me zotësi juridike të plotë për të vepruar.
- 19.2 Shoqëria mund të emërojë një ose dy administratorë .
- 19.1 Kohëzgjatja e detyrës së administratorit është 1 vit me të drejtë rizgjedhje.

Neni 20

Të Drejtat dhe Detyrat e Administratorit

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

Të kryjë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Ortaku I vetëm I shoqërisë;

Të përfaqësojë shoqërinë tregtare në mardhënie me të tretët dhe me gjithë institucionet shtetërore në nivel vendor dhe qëndror, madje përfaqësimi i shoqërisë në instancat gjyqësore, administrative;

Të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;


Të përgatisë dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportini e ecurisë së veprimtarisë si dhe propozimet për shpërndarjen e fitimit, duke ia paraqitur këto për miratim Asamblesë së shoqërisë;

Të raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të posaçme për shoqërinë.

Të kryej regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë sipas parashikimeve të ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Bisnesit”.

Asambleja e Përgjithshme mund ta shkarkojë në çdo kohë administratorin e shoqërisë me shumicë të zakonshme. Zgjidhja e menjëherëshme e kontratës së punës me administratorin do të bëhet në bazë të parashikimeve të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 21



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Kadiu". Above the signature, the number "7" is written in a small circle.

Administratori I shoqërisë është I detyuar të jetë besnik ndaj shoqërisë dhe ortakut të vetëm të saj, sipas parashikimeve të neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Administratori I shoqërisë, është I detyruar të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në këtë statut në mirëbesim dhe në interesin më të lartë të shoqërisë. Administratori është I detyruar t'I ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe me kujdesin e nevojshëm.

Administratori I shoqërisë përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë, me përashtim të rastit kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatës, veprimi apo mosveprimi është kryer në mirëbesim. Nëse vërtetohet rasti sa sipër Administratori është I detyruar të shpërblejë shoqërinë për çdo dëm të ardhur, si dhe të kthejë çdo përfitim që ai vetë apo personat e lidhur me të kanë realizuar për shkak të veprimeve të paligjshëm.

Neni 22 Shpërblimi I Administratorit

Shpërblimi për administratorin, tej shpenzimeve të ndodhura gjatë kryerjes së detyrave normale të administrimit të shoqërisë, do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë. Shpërblimi bazë të administratorit mund t'I bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim apo të ngashume.

Titulli V Bilanci dhe mjetet

Neni 23

Çdo vit financiar fillon në Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti, duke përashtuar vitin e parë i cili fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë.

Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi operacionet e viti financiar dhe raportet e veçantë të hartuara nga Administratori dhe eventualisht nga ekspertë kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja me shumicë votash (shumicë që përfaqëson më shumë se 1 / 2 e kapitalit të shoqërisë).

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore të Shoqërisë bëhet brenda një afati prej tre muajsh nga dita e mbylljes së viti financiar.

Titulli VI Dividentet dhe Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Neni 24 Dividentët

- Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, Shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividentëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- Me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividentët deklarohen dhe paguhën në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividenti. Të gjithë dividentët pjestohen dhe paguhën në përpjestim të

drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividenti; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividentit nga një datë e caktuar, dividenti do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

- Asnjë divident ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të marrë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
- Çdo divident që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 25 Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Titulli VII Prishja dhe likuidimi

Neni 26

Shoqëria prishet në të gjitha rastet e parashikuara nga ligji. Shoqëria mund të prishet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme shoqërisë kur për këtë vendosin jo më pak se $\frac{3}{4}$ e kapitalit të shoqërisë.

Neni 27

Shoqëria hyn në likujdim në momentin e prishjes së saj. Asambleja e Përgjithshme do të përcaktojë modalitetet e likujdimit si dhe do të emërojë një ose më shumë likuidatorë. Likuidimi i shoqërisë do të bëhet sipas dispozitave ligure.

Titulli VIII Mardhëni e punës


Neni 28

Mardhëni e punës midis shoqërisë dhe të punësuarve do të përcaktohen nga kontrata individuale dhe kolektive e punës. Për ato çka nuk parashikohet në këto kontrata do të zbatohet legjislacioni ekzistues i punës.

Titulli IX Kompetenca gjyqësore

Neni 29

Çdo mosmarëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin e këtij statuti apo akteve të tjera të shoqërisë, ose mosmarëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast se ky nuk arrihet kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Tirana". A small number '9' is written near the bottom right of the signature.

Neni 30
Njoftimet

- Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit , duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke i dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote , të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të ligjit.
- Ky statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentat e tjera , raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohen nga administratori në faqen e internetit të shoqërisë , sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet).

Të tjera

Cdo gjë tjetër, e cila nuk është përmendur në kët statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

Titulli X
Dispozita të përgjithshme

Neni 31

Për atë çka nuk është thënë shprehimisht në këtë statut do të referohet në ligjin 9901, dt. 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodin Civil, si dhe në ligje të tjera Shqiptarë në fuqi.

ORTAKËT THEMELUES

SHOQËRIA PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**“ECO BUILDING GROUP” LTD
PËRFAQËSUAR NGA
Av. Rigert KONI**

